

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6519  
E mërkurë, 26 janar 2022  
çmimi 0.40 €

## Dy të vdekur dhe 2 707 raste të reja me Covid në Kosovë



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

TRANSPARENCY INTERNATIONAL KA PUBLIKUAR INDEKSION  
E PERCEPTIMIT TË KORRUPSIONIT

## KOSOVA SHËNON PËRPARIM NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT



Raporti i Transparency International për Indeksion e Perceptimit të Korruptionit për vitin 2021 ka treguar se Kosova ka shënuar përparim të lehtë në luftën kundër korruptionit. Në këtë raport Kosova është vlerësuar me 39 pikë, tri më shumë se në vitin e kaluar. Për ngritjen e Kosovës për 17 vende në këtë indeks, kryeministri Albin Kurti dhe ish-kryeministri Avdullah Hoti kanë marrë meritat, duke pretenduar se ky përparim është arritur falë qeverisjes së tyre

### AKTUALE



**"PFIZER" DHE "BIONTECH" NISIN  
PROVAT KLINIKE PËR VAKSINËN  
KUNDËR OMICRONIT**

**PSD-JA FTON OPOZITËN T'I  
BASHKOHET NË PROTESTËN  
E 29 JANARIT**

**LUMEZI THOTË SE BRENDA  
SISTEMIT TË DREJTËSISË KA GJËRA  
QË DUHET TË PËRMIRËSOHEN**

**ISH-USHTARËT E UÇK-SË  
SHPALOSIN FLAMURIN "LIRIA KA  
EMËR" NË KALANË E  
GJIROKASTRËS**

**Abdullahu: Qeveria  
Kurti po keqmenaxhon  
pandeminë, urgjentisht  
të lirohen masat**



**KONJUFCA ME DEPUTETËT  
E SHQIPËRISË:  
TË GJITHA SFIDAT MUND T'I  
PËRBALLOJMË BASHKËRISHT**

### EKONOMI



**NË VERI S'DO TË KETË RITJE  
TË TARIFAVE TË ENERJISË  
ELEKTRIKE**

**MUSLIU E NAÇO ZOTOHEN PËR  
RRITJEN E BASHKËPUNIMIT NË  
SEKTORIN E SIGURISË**

### SPORT

**SONTE DY SUPERNDESHJE  
NË LIGËN UNIKE**

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Rusia stërvitet në Krime

MOSKË, 25 JANAR - Ushtria ruse ka njoftuar të martën se ka nisur stërvitje ushtarake në jug të Rusisë, pranë Ukrainës, dhe në Krime, që Moska e ka aneksuar nga Kievi.

Në këto stërvitje po marrin pjesë 6 000 trupa dhe të paktën 60 avionë luftarakë, tha ushtria.

Ushtria ruse ka njoftuar se në këto stërvitje do të bëhet një kontroll i gatishmërisë ushtarake në kohën kur tensionet midis Moskës dhe Perëndimit janë rritur për Krimenë dhe Ukrainën. “Njësitë do ta praktikojnë kryerjen e një sërë detyrash, përfshirë edhe organizimin e mbështetjes gjithëpërfshirëse për stërvitje taktike. Ushtrimet ushtarake do të mbahen duke përdorur të gjitha llojet e avionit, divizioneve të

raketave dhe grupeve të ndryshme të anijeve të Flotës në Detin e Zi dhe asaj të Kaspikut”, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes së Rusisë.

Avionët luftarakë dhe bombarduesit do të ushtrojnë për të kryer sulme “ndaj caqeve në distancë maksimale”, thanë agjencitë e lajmeve ruse, duke cituar Ministrinë e Mbrojtjes.

Stërvitjet do të mbahen në Gadishullin ukrainas të Krimesë, që Moska ka aneksuar dhe në rajonet në jug të Rusisë, në Rostov dhe Krasnodar.

Rusia nuk ka njoftuar se deri kur pritet të mbahen këto stërvitje.

Ukraina dhe Perëndimi kanë fajësuar Rusinë se po përgatitet që ta pushtojë Ukrainën pasi ka vendosur mbi 100 000 trupa në kufi.



## “Pfizer” dhe “BioNTech” nisin provat klinike për vaksinën kundër Omicronit



NJU-JORK, 25 JANAR - Kompanitë “Pfizer” dhe “BioNTech” njoftuan më 25 janar se kanë nisur provat klinike për të testuar një version të ri të vaksinës së tyre, që është veçanërisht e dizajnuar për variantin Omicron të koronavirusit, pasi që varianti Omicron duket se shpang mbrojtjen e ofruar nga marrja e dy dozave të vaksinës.

Kompanitë thanë se kanë në plan të testojnë përgjigjen imunitare të këtij versioni të ri të vaksinës për Omicron si përmes dhënies së tri vaksinave të personat e pavaksinuar, po ashtu edhe përmes dhënies së dozës përfunduese të njerëzimit që veçse kanë marrë dy dozat e para të vaksinës

“Pfizer/BioNTech”. Po ashtu, do të testohet edhe doza e katërt e vaksinës ekzistuese dhe doza e katërt e vaksinës që ka në shënjestër Omicronin të personat që para gjashtë muajve janë vaksinuar me tri doza të vaksinës “Pfizer/BioNTech”.

Kompanitë, po ashtu, planifikojnë të studiojnë sigurinë dhe tolerancën e dozave në mbi 1 400 persona që janë regjistruar për të marrë pjesë në këto prova. “Ndërsa studimet aktuale dhe të dhënat reale thonë se dozat përfunduese ofrojnë mbrojtje të lartë kundër sëmurjes së rëndë dhe hospitalizimeve nga Omicroni. Ne e dimë se duhet të përgatitemi që nëse mbrojtja nga vakcina zbehet me

kalimin e kohës dhe për të ndihmuar në shënjestrimin e Omicronit dhe varianteve të reja në të ardhmen”, tha Kathrin Jansen, që udhëheq Departamentin për Hulumtime dhe Zhvillim të Vaksinave në “Pfizer”.

“Pfizer” tha se regjimi me dy doza të vaksinës origjinale mund të mos ofrojë mbrojtje të mjaftueshme kundër infektimit me variantin Omicron. Megjithatë, qendrat amerikane për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve thonë se marrja e tri dozave të “Pfizer/BioNTech” dhe “Moderna” ofrojnë 90 për qind mbrojtje nga hospitalizimet.

## Aeroporti i Stambollit vonon rihapjen për shkak të borës

STAMBOLL, 25 JANAR - Aeroporti i Stambollit ka vonuar rihapjen të martën, pasi qyteti më i madh i Turqisë është zgjuar në një borë masive, e cila ka paralizuar trafikun dhe ka penguar shërbimet.

Ky aeroport ka më së shumti qarkullim në Evropë.

Një stuhi e borës ka mbyllur Aeroportin e Stambollit për herë të parë prej kur ka marrë primatin ndaj Aeroportit Ataturk, si qendër e re e

kompanisë Turkish Airlines më 2019.

Zyrtarë të aeroportit kanë njoftuar të martën se fluturimet nuk do të rinisin deri në orët e pasdites.

Në qytetin me 16 milionë banorë është parë pak qarkullim dhe kompanitë e dërgesave të ushqimit nuk kanë punuar.

Zyra e guvernatorit u ka bërë thirrje banorëve që kanë braktisur makinat e tyre nëpër autostrada që të

shkojnë edhe t’i marrin ato. “Ju lutem, le t’i marrim makinat tona”, ka thënë guvernatori Ali Yerlikaya.

Mbyllja e Aeroportit të Stambollit ka ndikuar në fluturimet drejt Lindjes së Mesme, Afrikës, Azisë dhe Evropës.

Aeroporti i Stambollit u ka shërbyer më shumë se 37 milionë pasagjerëve vitin e kaluar pavarësisht prej pengesave të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit.



## Rusia shton Navalyn në listën e “terroristëve”

MOSKË, 25 JANAR - Rusia ka shtuar kritikun e burgosur të Kremlinit, Aleksei Navalny dhe disa aleatë të tij, në listën e “terroristëve” dhe ekstremistëve.

Autoritetet ruse kanë shtuar

Navalyn dhe pesë bashkëpunëtorët e tij, Lyubov Sobol, Vyacheslav Gimadi, Georgy Albuov, Lilia Chanysheva, dhe Ruslan Shaveddinov më 25 janar, duke i vendosur në nivelin e

njëjtë me grupet nacionaliste të krahut të djathtë dhe organizata të huaja terroriste sikurse talebanët dhe i ashtuquajturit Shteti Islamik. Sipas ligjit rus, llogaritë bankare të këtyre individëve të

shtuar në listë duhet të bllokohen menjëherë. Më pak se dy javë më parë dy bashkëpunëtorë të ngushtë të Navalnyt, Leonid Volkov dhe Ivan Zhdanov, janë shtuar në listë.



# Abdullahu: Qeveria Kurti po keqmenaxhon pandeminë, urgjentisht të lirohen masat

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 JANAR - Zëdhënësi i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Faton Abdullahu, në një konferencë për medie, e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për mungesë vizioni dhe paaftësi të menaxhimit të pandemisë.

Abdullahu ka thënë se PDK-ja i konsideron të ngutshme, joprofesionale dhe të dëmshme në shumë dimensione masat e fundit kundër Covidit të vendosura nga qeveria. "Në vend të masave ekstreme të mbylljes, PDK-ja rekomandon që qeveria t'i rritë kapacitetet menaxhuese dhe t'i zbatojë masat e duhura në mënyrë që qytetarët e vaksinuar me dy doza të kenë mundësi të lëvizin lirshëm pa kufizime dhe bizneset të kenë mundësi të operojnë pa u penalizuar. Masat e fundit të qeverisë, posaçërisht ajo për pasjen e vaksinës së tretë si kusht për hyrjen në Kosovë janë, pos të tjerash, edhe shkelje e të drejtave, sidomos në raport me qytetarët shqiptarë të vendeve përreth. Këta qytetarë kanë lidhje ta pandalshme organike me Kosovën, si ato familjare, ashtu edhe ato biznesore, si ato në arsim, ashtu edhe në fusha të tjera të jetës e punës", ka thënë ai.

Abdullahu ka theksuar se kjo kërkesë e qeverisë karshi shtetasve të huaj, sidomos të shqiptarëve jashtë Kosovës, është shkelje e të drejtave të tyre elementare.

"Partia Demokratike e Kosovës kërkon që qeveria, konkretisht



Ministria e Shëndetësisë, t'i rishqyrtojë urgjentisht masat e fundit kundër Covidit, me qëllim që t'i ndryshojë ato e, për rrjedhojë, ta ndalë dëmin e shkaktuar dhe diskriminimin e zyrtarizuar", është shprehur Abdullahu.

PDK-ja kërkon urgjentisht të

ndryshohen masat kundër Covidit, sidomos atë që kërkohet vakcina e tretë për qytetarët që duan të hyjnë në Kosovë, sepse Kosova është dhe duhet të jetë e të gjithë shqiptarëve. "Prej kur është shfaqur për herë të parë koronavirusi në Kosovë, vendi

është udhëhequr nga qeveria e Albin Kurtit. Për fat të keq, që nga fillimi në asnjë moment kjo qeveri nuk ka ditur ta menaxhojë pandeminë, përkundrazi hapin e vetëm që ka ditur ta marrë ka qenë izolimi, mbyllja e qytetarëve dhe ndëshkimi i bizneseve. Si pasojë

e udhëheqjes së dobët e pa vizion, Kosova në këtë pandemi ishte vendi i fundit që siguroi testet dhe vendi i fundit që siguroi vaksinat. Tani po mbetemi vendi i fundit i izoluar e me masa të rrepta në mungesë të menaxhimit të duhur nga kjo qeveri", ka thënë Abdullahu.

## Dy të vdekur dhe 2 707 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 JANAR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, të martën, prej 11 144 testeve të bëra, 2 707 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar dy raste të vdekjes.

Sot janë shënuar edhe 556 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shënuarve është 161 726. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 21 668.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 6 492 doza të


vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 754 334 doza të vaksinës. Deri më sot 802 301 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 44 143 doza përforcuese dhe 16 991 doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.

## PSD-ja fton opozitën t'i bashkohet në protestën e 29 janarit

PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Partia Socialdemokrate (PSD) u ka bërë ftesë deputetëve të partive opozitare që të marrin pjesë në protestën e organizuar nga ajo më 29 janar përmes së cilës do të kundërshtohet shtrenjtimi i energjisë elektrike.

Aktivistë të PSD-së këto ftesa i kanë dorëzuar në Kuvendin e Kosovës dhe të cilat dedikoheshin për deputetët nga radhët e opozitës. Sekretarja e përgjithshme e PSD-së, Teutë Rrusta, u shpreh se në këtë situatë kur vendi po ballafaqohet me krizën e

pandemisë dhe atë energjetike, deputeti opozitar ka përgjegjësi më të madhe. Ajo ka kërkuar nga opozita që mos t'i ngushtojë aktivitetet brenda institucioneve, por të përdorin të gjitha instrumentet për të gjetur zgjidhje për krizën energjetike.





TRANSPARENCY INTERNATIONAL KA PUBLIKUAR INDEKsin E PERCEPTIMIT TË KORRUPSIONIT

# Kosova shënon përparim në luftën kundër korrupsionit

Raporti i Transparency International për Indeks të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2021 ka treguar se Kosova ka shënuar përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit. Në këtë raport Kosova është vlerësuar me 39 pikë, tri më shumë se në vitin e kaluar. Për ngritjen e Kosovës për 17 vende në këtë indeks, kryeministri Albin Kurti dhe ish-kryeministri Avdullah Hoti kanë marrë meritat, duke pretenduar se ky përparim është arritur falë qeverisjes së tyre

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 25 JANAR - Republika e Kosovës ka shënuar përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit në Indeks të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2021 të përpiluar nga organizata ndërkombëtare Transparency International. Sipas këtij raporti, Kosova është vlerësuar me 39 pikë, tri më shumë se në vitin e kaluar. Në krahasim me vitin e kaluar, raporti i këtij viti tregon se Kosova është ngritur për 17 vende në Indeks të Perceptimit të Korrupsionit. Publikimi i këtij raporti ka nxitur reagime të ndryshme në vend. Kryeministri Albin Kurti dhe ish-

kryeministri Avdullah Hoti kanë reaguar për të marrë meritat për përparimin që ka shënuar Kosova në këtë fushë.

Kurti ka theksuar se zotimi i qeverisë së tij për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit institucional është duke dhënë sinjalet e para. "Zotimi ynë për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit institucional është duke dhënë sinjalet e para shumë optimiste. Nga pozita 104 në pozitën e 87, në Indeks të Perceptimit të Korrupsionit, Kosova e ka përmirësuar pozitën e saj për 17 vende. Ende pa u bërë një vit nga marrja e detyrës, veprimet tona kundër korrupsionit vlerësohen pozitivisht nga organizata

kredibile. Sigurisht që duhet edhe më mirë e sigurisht që do të punojmë më shumë derisa Kosova të jetë afër e bashkë me vendet e pastra për nga korrupsioni", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse ish-kryeministri Hoti ka thënë se ky përparim është falë punës së tij si udhëheqës i Qeverisë së Kosovës. Në "Facebook", Hoti ka publikuar një grafikë ku tregon se gjatë qeverisjes së Isa Mustafës në vitin 2017, Kosova ishte renditur më së larti në këtë raport. "Dy qeveritë e

udhëhequra nga LDK-ja e kanë ndryshuar trendin për të mirë në çdo fushë", ka shkruar Hoti.

**Haxhiu: Kosova do t'i afrohet mesatares evropiane**

Raportin e Transparency International e ka komentuar edhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. Sipas saj, lufta kundër korrupsionit që kjo qeveri po bën po vlerësohet edhe ndërkombëtarisht. "Sot Transparency International ka njohur përparimin në luftën

kundër korrupsionit duke e renditur Republikën e Kosovës në vendin e 87 nga 180 vende. Në vitin 2020 ishim në vendin e 104-t, kurse sot jemi 17 vende më poshtë. Kosova ka marrë 39 pikë nga 100 të mundshme, por ky është vetëm fillimi. Synimi ynë është që brenda këtij mandati Kosova të arrijë mesataren globale e t'i afrohet mesatares evropiane", ka shkruar Haxhiu në "Facebook". Ajo ka përmendur edhe masat që qeveria i ka ndërmarrë në këtë drejtim. "Përkushtimi ynë në luftën kundër korrupsionit,

## Franca dhe Gjermania përshëndetin përparimin e Kosovës

Franca dhe Gjermania kanë përshëndetur përparimin e Kosovës në fushën e luftimit të korrupsionit. Përmes ambasadave të tyre në Prishtinë, këto vende janë shprehur të lumtura për përparimin e Kosovës. "Lajm i mirë. Kosova shënon përparim, duke u ngjitur 17 vende në krahasim me vitin e

kaluar në indeksin e perceptimit të korrupsionit. Duhet vazhduar këtë përparim. Franca e mbështet plotësisht Kosovën në luftën e vazhdueshme kundër korrupsionit", është thënë në postimin e ambasadës franceze. Ngritjen e Kosovës në këtë indeks si lajm të mirë e ka quajtur edhe Ambasada e Gjermanisë në

Prishtinë. "Lajme i mirë. Kosova bën përparim të dukshëm në luftimin e korrupsionit. Në indeksin e Transparency International, Kosova është përmirësuar me 17 vende dhe tani renditet në vendin e 87", kanë shkruar zyrtarë të Ambasadës së Gjermanisë në llogarinë e kësaj ambasade në "Facebook".

përveç kompletimit të pakos ligjore antikorrupsion, përkthehet gjithashtu përmes realizimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit, vettingut në drejtësi, jetësimin të Byrosë Shtetërore për verifikimin e pasurisë së pajustificueshme, por edhe me mbështetjen

buxhetore për sistemin e drejtësisë. Kosova ka shumë sfida, por edhe ne kemi vullnet të madh dhe nuk ndalemi deri në jetësimin e zotimeve tona”, ka shkruar ajo.

Raporti i Transparency International për Indeksin e

Perceptimit të Korrupsionit radhit çdo vit 180 shtete dhe territore të botës në bazë të nivelit të perceptuar të korrupsionit në sektorin publik. Ai përdor një metodologji pikësh, sipas së cilës, zero tregon për një vend shumë të korruptuar,

ndërsa 100 për një vend të pastër nga kjo dukuri. Nga vendet e rajonit, përparim ka shënuar edhe Maqedonia e Veriut, e cila ka 39 pikë, katër më shumë se në vitin e kaluar.

Shqipëria ka 35 pikë, një më pak se një vit më parë. Bosnjë e

Hercegovina ka, po ashtu, 35 pikë, por nuk ka ndërruar pozitë. Serbia nuk ka ndërruar pozitë nga viti i kaluar, duke marrë sërish 38 pikë. Ndërsa Mali i Zi qëndron më së miri në rajon sa i përket luftës kundër korrupsionit, me 46 pikë, një më shumë se në vitin e kaluar.

## Buleshkaj: Do t'i trajtojmë me seriozitet rekomandimet e raportit të TI-së

Pas publikimit të Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit nga organizata Transparency International (TI), ka reaguar Agjencia Kundër Korrupsionit. Përmes një komunikate për medie, AKK-ja ka bërë me dije se

drejtori i kësaj agjencie, Yll Buleshkaj, është zotuar se do t'i trajtojë me seriozitet dhe përkushtim rekomandimet e dala nga raporti i Transparency International. “Me këtë rast, drejtori i Agjencisë Kundër

Korrupsionit, Yll Buleshkaj, është zotuar se AKK do t'i trajtojë me seriozitet dhe përkushtim rekomandimet e dala nga raporti i Transparency International, duke ngritur efikasitetin e veprimeve të AKK-

së për parandalimin dhe luftimin e Korrupsionit në Kosovë, të përqendruara në deklarimin e pasurisë, parandalimin e konfliktit të interesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Rekomandimet e

Raportit të Transparency International do të shndërrohen në objektiva pune të Agjencisë Kundër Korrupsionit, ka theksuar drejtori i AKK-së, Yll Buleshkaj”, është thënë në njoftimin e AKK-së.

## Konjufca me deputetët e Shqipërisë: Të gjitha sfidat mund t'i përballojmë bashkërisht

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 JANAR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i shoqëruar nga nënkryetarja Saranda Bogujevci dhe kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Ganimete Musliu, kanë pritur në një takim anëtarët e Komisionit për Sigurinë Kombëtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Kryetari Konjufca me këtë rast ka thënë se bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë ka qenë jo vetëm i domosdoshëm, por ka sjellë edhe rezultate historike për kombin. “Ne të gjitha sfidat i kemi kaluar së bashku gjatë historisë dhe fakti që gjendemi këtu, i kemi dy shtetet tona, është edhe për arsye se kemi vepruar gjithnjë në të njëjtin drejtim sipas një strategjie të përbashkët”, ka deklaruar Konjufca, duke

nënvizuar se Kosova dhe Shqipëria de jure janë dy shtete, por de fakto duhet të veprojmë bashkërisht. “Mendoj se vetëm përmes kësaj doktrine do të mund t'i përballojmë edhe sfidat nëpër të cilat po kalojmë aktualisht, por edhe ato të cilat do të na dalin përpara në një të ardhme të afërt”, ka theksuar Konjufca, duke shtuar se të gjitha sukseset e Kosovës, që nga lufta çlirimtare e vitit 1998-1999, shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008 dhe fitorja në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, nuk mund të imagjinohen pa ndihmën e Republikës së Shqipërisë.

Konjufca para anëtarëve të Komisionit për Siguri Kombëtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë paraqiti disa sfida të cilat kërkojnë bashkëveprim dhe bashkërendim të hapave. “Marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë, krizat globale, siç është rasti me pandeminë e virusit Covid 19, siguria



kibernetike dhe migrimi i të rinjve të të dyja vendeve, janë sfidat në të cilat duhet të punohet së bashku, në mënyrë që Kosovës dhe Shqipërisë të mos u rrezikohet siguria kombëtare”, ka thënë ai.

Edhe kryetari i Komisionit për Siguri Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, Nasip Naço, ka

shprehur gatishmërinë e bashkëpunimit të ndërsjellë. “Ne jemi të gatshëm gjithnjë për një bashkëpunim të ndërsjellë, për të shkëmbyer mendime dhe informacione mes dy parlamenteve. Sigurisht që sfidat tona janë edhe më të mëdha dhe duke u takuar dhe shkëmbyer informacione, besoj se do të

veprojmë njëloj për t'i përballuar ato”, ka thënë Naço.

Në takim kanë folur edhe anëtarët e tjerë të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe të Komisionit për Siguri Kombëtare të Shqipërisë, të cilët u pajtuan që të thellohet bashkëpunimi në mes të këtyre dy komisioneve.

## BE-ja konfirmon vizitën e Escobarit dhe të Lajçakut në Kosovë dhe Serbi

PRISHTINË, 25 JANAR - Shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, konfirmoi se javën e ardhshme në Kosovë dhe Serbi do të qëndrojë i dërguari i posaçëm për dialogun, Miroslav Lajçak dhe i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Në një konferencë të përbashkët për medie në Bruksel me kryeministren e Serbisë, Ana Bërnabiq, Borrell tha se qëllimi i kësaj vizite do të jetë angazhimi për vazhdimin e dialogut për normalizimin e raporteve midis Kosovës dhe Serbisë.

Përgjegjësinë për ngecje në procesin e dialogut Borrelli e barti më shumë të zyrarët në



Prishtinë. “Dua t'ia bëj të qartë Kosovës se dialogu nuk zhvillohet për shkak të dialogut, por për shkak se është kyç për përparimin në rrugëtimin evropian. Së bashku

me Lajçakun do të vazhdojmë ta përgatitim takimin e radhës, por kjo do të ndodhë vetëm nëse të dyja palët merren vesh rreth rezultateve pozitive dhe konkrete. Prandaj unë dhe

Lajçaku do të vazhdojmë të angazhohemi me palët, posaçërisht me Kosovën, e cila po dëshmon më shumë jogatishmëri për t'u ulur në tryezë”, ka thënë Borrell.

Borrelli ka përsëritur thirrjen që të zbatohen të gjitha marrëveshjet që janë arritur deri tash në dialogun që e ndërmjetëson blloku evropian. Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011. Raundi i fundit i dialogut në nivel të lartë, ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, është mbajtur në korrik të vitit 2021. Ndërkaq, të martën në Bruksel u mbajt takimi i Këshillit të Stabilizim Asocimit ndërmjet

Serbisë dhe BE-së. Pas këtij takimi, BE-ja përsëriti qëndrimin se edhe për Serbinë përparimi në procesin e integritimit evropian varet nga normalizimi i raporteve me Kosovën dhe nga shpejtësia e procesit të reformave, veçmas në fushën e sundimit të ligjit. Borrelli, po ashtu, ka bërë thirrje për forcimin e bashkëpunimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe ka përsëritur se në Evropë nuk ka vend për glorifikimin e kriminelëve të luftës apo të mohimit të gjenocidit.

Kryeministrja serbe Ana Bërnabiq ka thënë se për shtetin e saj bashkëpunimi rajonal është pjesë e rrugës evropiane.

## Totaj u kërkon drejtorëve angazhim në punë

**PRIZREN, 25 JANAR (ER)** - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, në prani të kabinetit të drejtorëve komunalë, ka mbajtur mbledhjen e radhës, në të cilën ka diskutuar çështje të rëndësishme të menaxhimit të drejtorive komunale dhe fushëveprimit të mbledhjes

javore të drejtorëve. Totaj ka paraqitur mënyrat e funksionimit të punës si kabinet qeveritar dhe brenda drejtorive, po ashtu, ka parashtruar kërkesat për drejtorët për përpilimet e planeve vjetore të punës, të organizimit të të punësuarve brenda drejtorive dhe

funksionet që ata duhet të kryejnë drejt arritjes së objektivave të përgjithshme të qeverisjes lokale. Në këtë takim drejtorët komunalë kanë raportuar për punën e tyre të deritanishme, kërkesat që kanë dhe analizat e brendshme që i kanë bërë pas marrjes së detyrës.



## Inspektorët komunalë vazhdojnë aksionin për lirim e hapësirave publike në Mitrovicë

**MITROVICË, 25 JANAR** - Drejtoria e Inspeksionit në Mitrovicë, me asistimin e Policisë së Stacionit Jugor në këtë qytet, po vazhdon planin dinamik të punës për lirim e trotuareve dhe të hapësirave publike në tërë qytetin e Mitrovicës. Aktivitetet e tilla janë ndërmarrë pas kërkesave të shumta të adresuara nga

qytetarët të cilët kanë shprehur pakënaqësitë e tyre për pengesa dhe vështirësi të lëvizjes përgjatë trotuareve në disa lagje të qytetit. Drejtori i Inspeksionit, Valon Brahimi, ka paralajmëruar se aksione të tilla do të ketë në vazhdimësi. "Hapësirat e ndryshme, si trotualet, rrugët dhe ambientet e tjera të cilat janë zënë

pa të drejtë si nga bizneset ashtu edhe nga individët, kanë sjellë që shumë qytetarë të ecin përgjatë rrugëve duke u rrezikuar edhe nga aksidente të ndryshme të trafikut, andaj Drejtoria e Inspeksionit do të përkujdeset për lirim e plotë të hapësirave publike", është shprehur drejtori Brahimi.



## Edhe pse rastet me Covid po shtohen, gjendja është nën kontroll në Malishevë



**MALISHEVË, 25 JANAR** - Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Malishevë, Hajdin Berisha, pas disa shqetësimeve të shfaqura në shkollën e fshatit Shkozë, për shkak të gripit sezonal dhe dyshimit për raste me Covid, pas vizitës së realizuar në shkollë, ka konstatuar se gjendja është nën kontroll dhe e menaxhueshme dhe se mësimi duhet të zhvillohet normalisht. "Pavarësisht prej dyshimeve të shfaqura, që janë normale në

këtë periudhë, qoftë për shkak të gripit sezonal, qoftë për shkak të rritjes së rasteve me Covid në vendin tonë, situata në këtë shkollë është në suaza të normales dhe nuk ka vend për panik", ka thënë Berisha. Pas takimit me drejtorin e shkollës Arben Bytyçi, Berisha ka thënë se është njoftuar për gjendjen e cila është duke u menaxhuar mirë dhe janë duke u përcjellë rastet e dyshuara me grip apo edhe me Covid por, sipas tij, mësimi ka kushte të mbahet normalisht.

## Filloi shpërndarja e kifleve për nxënësit e ciklit të ulët në shkollat e Podujevës

**PODUJEVË, 25 JANAR (ER)** - Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Podujevë, Avni Fetahu, të martën ka vizituar shkollën fillore "Shaban Shala" dhe "Naim Frashëri" për ta parë ecurinë e procesit mësimor në këtë situatë epidemiologjike. Ai ka parë nga afër realizimin e projektit për shpërndarjen e

kifleve për nxënësit nga klasa e parë deri te klasa e pestë. Ky projekt ka filluar të implementohet nga mbështetja e nivelit qendror për komunat e cila ka ndarë mjetet buxhetore, ndërsa komunat, përkatësisht drejtoritë e arsimit, e kanë për detyrë përcjelljen dhe zbatimin

e këtij projekti. Komuna e Podujevës është prej komunave të para e cila ka filluar ta zbatojë këtë projekt. Gjatë vizitës në shkolla drejtori Fetahu ka shprehur kënaqësi për arritjen e realizimit të këtij projekti dhe ka njoftuar se nga ky projekt do të përfitojnë 37 shkolla me mbi 7000 nxënës.



## Nura: Brenda pak ditësh do ta hapim derën e shërbimeve në QMF-në e Likocit

**SKENDERAJ, 25 JANAR (ER)** - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka vizituar Qendrën e Mjekësisë Familjare në fshatin Likoci e cila është e mbyllur. Ai ka premtuar se brenda pak ditësh do të

hapet dera e shërbimeve në QMF-në e Likocit. "Mungesa e shërbimeve mjekësore jo vetëm për banorët e Likocit e Drenicës, por edhe më gjerë, si dhe mbyllja e Qendrës e Mjekësisë Familjare në këtë bashkësi

lokale, janë të papranueshme. Një vend që në rrethana luftime ka ofruar këto shërbime. Nuk do ta lëmë Likocin e historisë dhe fshatrat e tjera të kësaj pjese pa shërbime", ka thënë kryetari Nura.



# Lumezi thotë se brenda sistemit të drejtësisë ka gjëra që duhet të përmirësohen

PRISHTINË, 25 JANAR - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka marrë pjesë në tryezën e pestë të Komitetit Drejtues të Programit të Bashkimit Evropian për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë "EUKOJUST". Qëllimi i kësaj tryeze ishte paraqitja e raportit për ndarjen e pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeprokurori Lumezi vuri theksin në ndarjen e pushteteve, respektimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe bashkëpunimin ndërinstytucional në kuadër të përgjegjësisë dhe kompetencave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi.

Duke folur për pavarësinë

institucionale, kryeprokurori i Shtetit ka theksuar se nuk është rastësi ndarja e pushteteve dhe se kjo ndarje duhet të respektohet nga të gjithë. "Nuk është rastësi as fakti se jemi mekanizëm i pavarur kushtetues. Ne bëjmë punën tonë. Pavarësisht nëse kjo i pëlqen dikujt tjetër apo jo. Mirëpo është jetike për një shtet demokratik dhe për një shoqëri demokratike që ndarja e pushteteve të mos figurojë vetëm si garanci kushtetuese në letër, por kjo të garantohet në praktikë dhe të respektohet plotësisht. Veprimtaria e organeve të pushtetit gjyqësor nuk mund të kontrollohet nga organet e një pushteti tjetër", ka potencuar Lumezi.

Kryeprokurori i Shtetit ka



deklaruar se edhe brenda sistemit të drejtësisë ka gjëra që duhet të përmirësohen, mirëpo adresimi i tyre duhet të bëhet vetëm nga institucionet e pavarura

kushtetuese, përkatësisht nga pushteti gjyqësor dhe jo nga pushtetet e tjera. "Nuk pretendoj se ne nuk kemi gabime, mirëpo gabimet që kemi, duhet të

adresohen vetëm nga institucionet e pavarura kushtetuese, përkatësisht nga pushteti gjyqësor. Andaj ekzekutivi dhe legjislativi mund ta përmirësojnë punën tonë, duke na ndihmuar me përkrahje në buxhet, miratim të ligjeve dhe respektim të pavarësisë që kemi, si dhe me anë të fuqizimit të mekanizmave brenda vetë sistemit për t'i adresuar problemet dhe lëshimet e hasura deri më tani", ka thënë Lumezi, duke shprehur gatishmërinë e tij për ta rritur bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet e tjera, mirëpo vetëm në suaza të mosdërhyrjes në punët e njëritjetrit dhe duke respektuar pavarësinë institucionale dhe kushtetuese.

## Kurti: Agjencinë e Akreditimit synojmë ta bëjmë tërësisht të pavarur

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 JANAR - "Zhvillimet e sotme në nivel global na kanë ekspozuar përballë një mori sfidash, ballafaqimi me të cilat kërkon sistem arsimor të fuqishëm. Kosova si shoqëri nuk mund të jetë immune ndaj këtyre sfidave. Në shumicën e rasteve është edhe pasqyrimi brutal i tyre sikurse e patëm rastin me inflacionin", ka thënë kryeministri Albin Kurti në paraqitjen e aktiviteteve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për vitin 2021 dhe strategjinë e saj 2021-2025.

Ai ka thënë se si qeverisje kanë



trashëguar edhe një sistem arsimor i cili është rezultat i një politike publike, që në masë të

madhe ka qenë elektorale e shumë pak ose aspak strategjike e vizionare. "Një sistem, ku

interferimet politike, që nga rekrutimet e stafit në të gjitha nivelet, e deri tek ushtrimi i funksioneve të institucioneve të pavarura ekzekutive, siç ka qenë rasti me Agjencinë e Akreditimit, kanë qenë praktikë e stabilizuar", ka thënë Kurti. Sipas tij, këto interferime e kanë pamundësuar krijimin e një sistemi të qëndrueshëm arsimor, i cili do ta mundësonte orientimin e qytetarëve dhe rinisë drejt karrierave të qëndrueshme profesionale. "Në këtë kontekst, kur është fjala për Agjencinë e Akreditimit, ne synojmë që këtë institucion ta bëjmë tërësisht të pavarur për ekzekutimin e politikave arsimore. Interferimet

politike në Agjencinë në të kaluarën do të ngelen në të kaluarën", ka thënë kryeministri Kurti.

Kurti ka rikonfirmuar mbështetjen e plotë për Agjencinë në përpjekjet e saj për t'i adresuar dhe për t'i përmbushur rekomandimet dhe ka shprehur synimin e patjetërsueshëm të qeverisjes për rikthimin në ENQA dhe EQAR. "Kemi arritur në të bërit e arsimit të lartë më gjithëpërfshirës dhe më të qasshëm, duke hequr tarifat semestrale, por kemi ende rrugë për të bërë, që këtë nivel të arsimit ta bëjmë më atraktiv dhe më konkurrent ndërkombëtarisht", ka thënë Kurti.

## Ish-ushtarët e UÇK-së shpalosin flamurin "Liria ka emër" në Kalanë e Gjirokastrës

PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Disa ish-ushtarë të UÇK-së, të prirë dhe të mbështetur nga Shefqet Loshaj dhe Milaim Cakiqi, kanë organizuar një vizitë në qytetet e Shqipërisë, duke e filluar atë në Vlorë, vazhduar në Gjirokastrë, Sarandë, Durrës dhe përfunduar në Berat. Ata gjatë gjithë kohës kanë bartur të veshur uniformat me logon e UÇK-së dhe me mbishkrimin "Liria ka emër" në shenjë sensibilizimi dhe nderimi e respekti për drejtuesit e UÇK-së të cilët po mbahen padrejtësisht në Dhomat e Specializuara të Gjykatës Speciale në Hagë.



"Ishte kënaqësi e vërtetë kur ne hynim nëpër lokale nëpër qytetet shqiptare, në këtë rast në Gjirokastrë. Qytetarët dhe pronarët e

lokaleve na pritnin me ngrohtësi të madhe, duke u dërguar të fala çlirimtarëve që gjenden në Hagë", kanë theksuar këta



ish-ushtarë të UÇK-së. Një organizim edhe më madhështor pritet të bëhet në prag të ditës së shpalljes së pavarësisë së Kosovës

më 17 shkurt, ku do të shpaloset flamuri "Liria ka emër" në të gjitha qytetet e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë.

# Në veri s'do të ketë rritje të tarifave të energjisë elektrike

PRISHTINË, 25 JANAR - Me një letër të komandantit të KFOR-it në vitin 2009, Kosovës i ishte kërkuar që mos t'i shkyçë nga rrjeti elektrik qytetarët serbë në veri të vendit ani pse ata nuk paguajnë për energjinë elektrike që e shpenzojnë. Këtë informacion e tha të martën në Komisionin për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, Ymer Fejzullahu.

I pyetur se pse pjesa veriore e vendit nuk është përfshirë në raportin ku ZRrE-ja shqyrtoi dhe propozoi shtrenjtimin e energjisë elektrike, Fejzullahu ka thënë se për energjinë e papaguar elektrike në veri, ky institucion është paditur nga Avokati i Popullit dhe, si pasojë e kësaj çështjeje gjyqësore, çmimin e energjisë së papaguar në katër komunat veriore e paguajnë qeveria dhe KOSTT-i. "Edhe ajo pjesë ka qenë e përfshirë në tarifave

energjisë elektrike deri në vitin 2018. Avokati i Popullit ka ngritur një ankesë dhe e ka paditur ZRrE-në për të cilën jemi në proces gjyqësor. Ajo kosto nga dhjetori i vitit 2017 është hequr apo nuk është barrë e konsumatorëve dhe ajo ka kaluar përmes buxhetit të Kosovës, pastaj është mbuluar nga KOSTT-i dhe ZRrE-ja meqenëse ia ka ndaluar gjykata që ta përfshijë këtë kosto, ne nuk e kemi marrë parasysh as në kalkulimet e mëhershme meqenëse jemi në proces gjyqësor", ka thënë ai.

Fejzullahu ka thënë se ky është problem politik, ndërsa ka treguar se komandanti i KFOR-it në vitin 2009 kishte kërkuar që komunat veriore të mos shkyçen nga rrjeti energjetik. "Sa për informimin e publikut, në 2009-n kemi pasur edhe zyrtarisht letër nga komandanti i atëhershëm i KFOR-it i cili ka kërkuar që këto katër komuna nuk bën të



shkyçen nga rrjeti energjetik e për të cilën kanë qenë të informuar të gjithë, edhe kryeministri i atëhershëm, edhe presidenti, edhe drejtori i policisë dhe të gjitha institucionet për shkak se ajo është zonë ku jetojnë komunitetet e ndryshme dhe

rritet pasiguria", ka thënë ai. Për konsumatorët që preken nga shtrenjtimi i propozuar i energjisë elektrike nga ZRrE-ja, kryesuesi i bordit tha se bashkëndien me ta. "Unë kërkoj ndjesë, ndoshta dhe bashkëndiej me ata konsumatorë, sepse nuk kanë

alternativë tjetër. Nuk është ZRrE-ja e cila do t'i ofrojë alternativat për furnizim me energji elektrike. ZRrE-ja duhet t'ia reflektojë koston maksimalisht secilës kategori të konsumatorëve aq sa i kushton sistemit", ka deklaruar Fejzullahu.

## Musliu e Naço zotohen për rritjen e bashkëpunimit në sektorin e sigurisë

PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, i kryesuar nga Ganimete Musliu, kryetare, ka pritur të martën në takim Komisionin për Sigurinë Kombëtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të drejtuar nga Nasip Naço, kryetar.

Fillimisht, deputetja Musliu, në emër të komisionit të cilin e drejton, e ka falënderuar delegacionin nga Shqipëria që i është përgjigjur pozitivisht ftesës.

Pasi e ka paraqitur një rezymë për rolin dhe punën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Musliu ka vlerësuar se është e domosdoshme mbajtja e takimeve më të shpeshta, rrjedhimisht rritja e bashkëpunimit ndërmjet komisioneve.



Po ashtu, Musliu ka thënë se Kosova ka nevojë për përkrahjen e Shqipërisë, marrë parasysh përvojën e saj në fushën e sigurisë. "Mbi të gjitha, kemi nevojë që t'i

shkëmbejmë përvojat mes dy shteteve, duke pasur parasysh që Shqipëria ka përvojat më të gjata sesa shteti ynë", ka thënë Musliu. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se çdo ide, këshillë

apo sugjerim do të jetë e mirëseardhur dhe do të vlerësohet nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Ndërkaq, kryetari i Komisionit

për Sigurinë Kombëtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Nasip Naço, ka thënë se, përkundër faktit se Kosova është shtet i ri, Shqipëria mund të marrë përvojë nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. "Vlerësoj se mund të japim, por edhe të marrim përvoja të mira nga ju", ka thënë Naço.

Ai, po ashtu, ka thënë se bashkëpunimi dhe rritja e sigurisë është në dobi të të dyja shteteve.

Gjatë bashkëbisedimit, anëtarët e të dyja komisioneve janë pajtuar për rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave në sektorin e sigurisë. Komisioni për Sigurinë Kombëtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë po qëndron në Kosovë me ftesë të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

## Investim pesë milionë euro në rrjetin elektrik në Skenderaj

SKENDERAJ, 25 JANAR (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka pritur të martën në takim kryeshefin ekzekutiv të KEDS-it, Alpin Dogan dhe bashkëpunëtorët e tij në Kosovë. "Qëllimi i takimit ishte vazhdimi i bashkëpunimit i filluar vite më parë, me qëllim që

qytetarët të kenë shërbime cilësore të furnizimit me energji elektrike dhe mirëmbajtje sa më të mirë të rrjetit", thuhet në njoftimin e komunës.

Kryetari Nura dhe Dogan u pajtuan që ta vazhdojnë bashkëpunimin duke trajtuar me prioritet lagjet dhe fshatrat në të cilat ka nevojë të

investohen në rrjet siç është fshati Lubavec si dhe lagjet e fshatra të tjera të cilat janë të planifikuara për investime nga KEDS.

Përfaqësuesit e KEDS-it kanë bërë me dije se në Skenderaj do të investohen 5 milionë euro në rrjetin elektrik për ta përmirësuar dhe modernizuar atë.







**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Sonte dy superndeshje në Ligën Unike



**PRISHTINË, 25 JANAR** - Në mesjavë do të zhvillohet xhiroja e nëntë e Ligës Unike që do të sjellë përballje shumë interesante. Padyshim që ndeshja derbi shihet ndërmjet Pejës dhe Golden Eagle Yllit që zhvillohet të enjten. Sfidat pritet të jetë shumë interesante ndërmjet nënkampionit dhe kampionit, si dhe vendit të dytë në renditje kundër vendit të parë. Këto dy skuadra ishin përballur edhe në finale të Ligës Unike, edicionin e kaluar dhe për titull në Kosovë, ku kishte triumfuar skuadra nga Theranda. Pejanët kanë gjashtë fitore dhe dy humbje, kurse therandasit shtatë fitore dhe një

humbje. Në përballjen e këtij edicioni kishte fituar Ylli me rezultat 93:92. Sfidat e parë e kësaj xhiroje zhvillohet në mes të Teutës dhe Rahovecit. Takimi shihet shumë interesant, pasi durrsakët kanë katër fitore dhe katër humbje, ndërsa rahovecasit tri fitore dhe pesë humbje. Përballje interesante shihet edhe në mes të Prizrenit 16 dhe Tirana Neptun. Prizrenasit kanë pesë fitore dhe tri humbje, kurse tiranasit katër fitore dhe katër humbje. Në xhiron e nëntë do të përballen edhe dy skuadrat shqiptare, Vllaznia e Shkodrës dhe Kamza Basket. Shkodranët kanë një

fitore dhe shtatë humbje, kurse skuadra nga Kamza dy fitore dhe gjashtë humbje. Takimi është interesant pasi ndeshen skuadra e fundit dhe e parafundit në renditje.

## LIGA UNIKE - Java 9

**Të mërkurën takohen:**  
17:00 Teuta - Rahoveci  
19:00 Prizreni 16 - Neptun Tirana

**Të enjten takohen:**  
19:00 Peja - Golden Eagle Ylli  
19:00 Vllaznia - Kamza

## SHKURT

### Sot shpallen më të mirët e vitit në hendboll

Federata e Hendbollit të Kosovës (FHK) e vazhdon traditën e shpalljes së atyre që janë dalluar gjatë vitit paraprak. Ndonëse të sfiduar fuqishëm nga pandemia, sukseset e hendbollit kosovar gjatë vitit 2021 nuk kanë munguar. Dhe ata që janë dalluar gjatë vitit të kaluar, do të nderohen e falënderohen në ceremoninë që do të mbahet të mërkurën më 26 janar. Bordi i FHK-së ka vendosur që ceremonia "Laureatët e Vitit 2021" të mbahet në Hotel International Prishtina, më 26 janar nga ora 16:00.

### Muriqi refuzon ofertën e Saint-Etiennes

Sulmuesi i Lazios, Vedat Muriqi, e ka refuzuar një ofertë nga klubi francez Saint-Etienne. Siç është raportuar ditë më parë, trajneri i Saint-Etiennes, Pascal Dupraz, e ka theksuar në mënyrë specifike sulmuesin kosovar të drejtuesit e klubit si një ide interesante për t'u marrë në konsideratë. Teksa gjatë ditës së sotme gazeta italiane "Tuttosport" ka raportuar se Muriqi e ka refuzuar një ofertë që i ka ardhur nga klubi francez. Për Muriqin nuk janë duke munguar ofertat nga klubet angleze, ruse e turke. 27-vjeçari Muriqi, i cili ka kontratë me Lazion deri në vitin 2025, ka bërë 15 paraqitje në të gjitha garat deri më tani në këtë sezon, ku ka dhënë vetëm një asistim.

### Tri klube italiane në garë për Behramin

Futbollisti shqiptar Valon Behrami është larguar nga Genoa ditë më parë. Mesfushori nga Kosova kishte ende kontratë me klubin e madh italian, por ai e zgjodhi atë me marrëveshje me klubin. 36-vjeçari do të mbetet edhe më tej pjesë e futbollit italian, pasi për të ka oferta nga Seria B. Mediet në Itali kanë raportuar se janë tri skuadra që po garojnë për t'i marrë shërbimet e Behramit nga Seria B italiane. Tri ekipet pretendente për t'u futur në elitë, Monza, Brescia dhe Benevento, janë duke biseduar me Behramin. Lojtari është i gatshëm të mbetet edhe më tej pjesë e futbollit italian dhe pritet që gjatë kësaj jave të vendosë për njërin skuadër.

### Ish-trajneri i Prishtinës emërohet trajner i Kombëtares së Kroacisë

Ish-trajneri i Prishtinës, Damir Mulamerović, do të jetë trajneri i Kombëtares së Kroacisë. Mulamerović erdhi te Prishtina në vitin 2018 ku edhe pati disa suksese, derisa bardhekaltrit e kanë cilësuar si njërin nga periudhat më të suksesshme në histori të klubit. Prishtina i ka uruar për postin e ri me shpresën se sukseset e tij do të vazhdojnë edhe në kombëtaren kroate. "Klubi i Basketbollit Sigal Prishtina dëshiron ta përgëzojë trajnerin Damir Mulamerović për emërimin trajner i Kombëtares së Kroacisë. Sigal Prishtina me të si trajner ka shijuar një nga periudhat më të suksesshme në historinë e saj, duke fituar trofe të shumtë! Qyteti ynë dhe ekipi ynë do të jenë gjithmonë mirënjohës për kontributin tuaj! Ju urojmë suksese dhe fat të mirë në rrugëtimin tuaj të ri! Cestitamo vam Trainer!", ka shkruar KB Prishtina.

## Kosova 3x3 do të garojë në FIBA Europe Cup

**PRISHTINË, 25 JANAR** - Kosova 3x3 do të paraqitet sërish në garat ndërkombëtare në të dyja konkurrencat. Lojtarët/et që do ta përfaqësojnë Kosovën 3x3 do të marrin pjesë në kualifikimet për FIBA Europe Cup, që do të mbahet në Limassol të Qipros më 4 dhe 5 qershor 2022. Në këtë

turne te meshkujt do të marrin pjesë: Qipro, Shqipëria, Andorra, Azerbajxhani, Irlanda, Kosova, Luksemburgu dhe Malta, më pas do të hidhet shorti final. Ndërkohë, në konkurrencën e femrave do të garojnë Qipro, Andorra, Irlanda, Kosova, Luksemburgu dhe Malta. Po

ashtu, do të hidhet shorti se në cilin grup do të jenë Dardanet. Kjo është hera e dytë që Kosova 3x3 do të garojë në konkurrencën e femrave. Kombëtaresit kampione në kualifikime marrin pjesë në FIBA EUROPE CUP. Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) njofton se turneu selektiv se

kush do të garojë për Kosovën do të zhvillohet nga 30 prilli deri më 1 maj 2022. FBK-ja, gjithashtu, ju njofton se nga ky edicion do të fillojë edhe Liga në 3x3, garë që do të pranohet edhe nga FIBA, kurse detajet rreth pjesëmarrjes dhe zhvillimit të kësaj lige do të jepen më vonë.



## Drejtuesit e FFK-së vizituan klubet që ndodhen në Antali

ANTALI, 25 JANAR - Drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës, kryetari Agim Ademi dhe nënkryetari Bakir Burri, me bashkëpunëtorë, kanë vazhduar me vizitat e tyre në klubet e Superligës të cilat ndodhen në Antali për fazën

përgatitore. Pas vizitës te SC Gjilani, drejtuesit e FFK-së kanë vizituar Llapin, Dritën, Ballkanin dhe Prishtinën. Gjatë këtyre takimeve u diskutua për stinorin pranveror dhe zhvillimet e përgjithshme në futbollin e


Kosovës me qëllim të ngritjes së mëtejme organizative dhe të cilësisë së futbollit. "Ata vlerësuan faktin se klubet tona po kanë mundësi ta zhvillojnë fazën përgatitore në këtë vend bregdetar dhe po i matin forcat me klube nga vende të

ndryshme evropiane, duke shprehur shpresën se puna e tyre intensive do të ndikojë që në pranverë të kemi kampionat shumë interesant dhe joshës për dashamirët e futbollit", thuhet në njoftimin e FFK-së.



## Hyseni: Punimet për rregullimin e stadiumit do të fillojnë sapo të lejojnë kushtet atmosferike

GJILAN, 25 JANAR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka premtuar se stadiumi i qytetit do të jetë një nga prioritetet me të cilin do të merret që në fillim të mandatit. Për ta parë dinamikën e punimeve, përkatësisht arsyet e ngecjeve në realizimin e projekti, ai të martën ka mbajtur një takim me drejtuesin e kompanisë si dhe organin mbikëqyrës. "Së bashku me drejtorin teknik të 'Unikos Project', Arbër Shita, organin mbikëqyrës të projektit, Xhafer Xhelili dhe menaxherin e projektit, Fadil Sherifi, diskutuam sot rreth procesit dhe dokumentacionit të projektit 'Rikonstruimi i stadiumit të qytetit Gjilan', ka thënë Hyseni. Projekti për rregullimin e stadiumit ka filluar në vitin 2017 dhe ishte planifikuar të



përfundonte në fund të vitit 2020, por kjo nuk ka ndodhur ende si rrjedhojë e disa ndryshimeve, prandaj u rekomandua hartimi i dokumentacionit i cili do të jetë bazë për ekzekutimin e punimeve. Hyseni ka thënë se në pjesën perëndimore të stadiumit do të kryhen punime me intensitet të shtuar sapo të lejojnë

kushtet atmosferike. "Punimet në pjesën perëndimore të stadiumit pritet të fillojnë me intensitet të shtuar sapo kushtet atmosferike të jenë më të përshtatshme ashtu që Intelktualët dhe Skifterët të mund t'i shikojnë klubet e tyre të zemrës nga tribunat dhe në kushte shumë më të mira", ka shtuar Hyseni.

## Përplasja Duka-Veliaj, UEFA zbarkon në Tiranë: Ndërhyrjet politike të papranueshme

TIRANË, 25 JANAR - UEFA, maksimalisht e shqetësuar nga ndërhyrjet politike në zgjedhjet e Federatës së Futbollit të Shqipërisë, do t'i dërgojë këto ditë njerëzit e saj në Shqipëri për të diskutuar në lidhje me këto çështje duke ngritur edhe shqetësimin në lidhje me sigurinë e organizimit të finales së Ligës së Konferencës në Tiranë. Lajmi është dhënë nga agjencia prestigjioze ndërkombëtare e lajmeve "Associated Press", në një artikull dedikuar ngjarjeve të fundit në Shqipëri që kanë gjetur pasqyrim edhe në medie të ndryshme botërore. Fillimisht jepet lajmi për shpërthimin e lëndës plasëse në shtëpinë e Presidentit të Federatës Shqiptare të Futbollit, teksa më



pas bën me dije se ky incident ka nxitur qeverinë evropiane të futbollit, ta ngrëjë shqetësimin e sigurisë në lidhje me Tiranën si qytet mikpritës i finales së Europa Conference League në 25 maj. UEFA i ka komunikuar "Associated

Press"-it se zyrtarë të saj do të udhëtojnë shpejt në Shqipëri për të diskutuar në lidhje me shqetësimet e fundit për ndërhyrjet politike në sport para zgjedhjeve për postin e presidentit të Federatës.

### SHKURT

#### Fiorentina nuk heq dorë nga transferimi i Kumbullës

Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Marash Kumbulla, është rikthyer në formë të mirë dhe po luan me shumë në skuadrën e Romës. Më herët ishte raportuar se Kumbulla do të largohet nga Roma në afatin kalimtar të janarit, por tash gjërat kanë ndryshuar. Pavarësisht prej këtij perceptimi, në Itali mediet vijojnë të lidhin emrin e tij me një largim të mundshëm pasi Fiorentina vijon të mbajnë në listën e dëshirave. Gjithnjë sipas medieve italiane, Fiorentina e kërkon shqiptarin në formë huazimi.

#### Hodgsoni, trajner i ri i Watfordit

Ish-përzgjedhësi i Anglisë, Roy Hodgson, pritet ta marrë drejtimin e skuadrës së Watfordit, ka raportuar "Sky Sports" të martën. Bëhet me dije se marrëveshja është arritur dhe Hodgsoni pritet të paraqitet shumë shpejt. 74-vjeçari do të firmosë kontratë me Watfordin deri në fund të këtij edicioni, me mundësi vazhdimi, kurse në këtë post do ta zëvendësojë Claudio Ranierin e shkarkuar. Hodgsoni ka qenë i papunë prej vitit të shkuar kur u largua nga skuadra e Crystal Palacet. Ndërkohë, Watfordi zë vendin e parafundit në Premierë Ligë dhe po lufton për mbijetesë.

#### Fiton Chicago, mposhtet Utah Jazz

Kanë përfunduar disa takime në NBA, me skuadrat që zhvilluan spektakël para tifozëve. Ndeshja më dramatike ishte ajo në mes të Oklahoma City Thunderit dhe Chicago Bullsit, me këta të fundit që triumfuan me vetëm një pikë dallim, 111-110. Fitore në këtë rreth mori edhe Phoenix Sunsi që ia doli ta mposhtë Utah Jazzin me rezultat 115-109. Fitore po kaq të mundimshme mori edhe New Orleans Pelicansi që triumfoi përballë Indiana Pacersit 117-113. Një tjetër sfidë e zjarrtë ishte edhe ajo në mes të New York Knicksit dhe Cleveland Cavaliersit, që përfundoi 95-93.

#### Barça është afër marrëveshjes me Azpilicuetan

Raportohet tashmë si punë e kryer çështja e transferimit të Cesar Azpilicuetas te skuadra e Barcelonës. Klubi spanjoll e ka kërkuar me ngulm mbrojtësin e Chelseat, i cili është në fundin e kontratës së tij me "blutë". Katalanët raportohet se kanë marrëveshje në parim me lojtarin, por nuk mund ta transferojnë në këtë merkato. Jose Alvarez shkruan se Barcelona po punon që të marrë lojtarin si transferim të lirë gjatë verës. Kontrata që i është propozuar lojtarit do të jetë e vlefshme deri në vitin 2024, me opsion vazhdimi. Chelsea, në anën tjetër, vazhdon të presë për Cesarin që ta njoftojë vendimin e tij për të ardhmen.

## Verstappeni: Duhet fat për të dueluar dhe fituar 6-7 tituj kampionë bote

Max Verstappen fitoi vjet titullin e parë kampion bote në Formulën 1 pas një beteje të fortë me Lewis Hamiltonin që tituj kampionë ka 7. Duke folur për mediet, piloti

holandez i Red Bullit shprehet se për të ka për të qenë e vështirë të arrijë atë shifër titujsh që kanë Hamiltoni e Michael Schumacheri. "Unë desha një titull dhe ia dola

mbanë. Tashmë çdo gjë që do të mbërrijë do të jetë një bonus për mua. Për të dueluar dhe fituar 6 apo 7 tituj kampionë bote në Formulën 1 ka nevojë për fat. Ke nevojë

për një skuadër që të dominojë në pistë dhe nuk mund t'i kesh gjithnjë këto mundësi", ka thënë Verstappen. "Nëse do të humbas ndonjë garë do të

inatosem, si gjithnjë, por mendoj se pas disa minutash gjithçka do të jetë harruar. Të shohim se çfarë do të sjellë e ardhmja për mua", u shpreh piloti holandez i Red Bullit.

**MILLENNIUM  
FOUNDATION  
KOSOVO****SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)**

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Contract for the Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER) – Gjakova
Procurement Ref. Number	RFQ / 2022/No. 004
Type of Procurement	Works
Employer	Millennium Foundation of Kosovo (MFK)
Publication Date	24 January 2022
Submission Deadline	14 February 2022; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the “Threshold Program agreement”, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for the Contract for the Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER) – South Mitrovica.

MCC’s funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now *bids* from eligible *bidders* for the Works Requirements.

Bidding will be conducted through the *Shopping* procedures as specified in the MCC Program Procurement Guidelines (PPG), and is open to all eligible bidders or consultants as defined in the PPG.

A complete set of Request for Quotation (RFQ) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible bidders through the following website (Eventual clarifications or any changes to the RFQ document shall be published at the latest 3 days before the submission deadline on the link provided below):

<https://millenniumkosovo.org/procurement/procurement-of-contract-for-the-construction-of-apartment-building-efficiency-retrofits-aer-gjakova-rfq-2022-004>

Bidders interested in submitting bids should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the RFQ to the Procurement manager at [procurement@millenniumkosovo.org](mailto:procurement@millenniumkosovo.org), giving full contact details of the bidder.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link (dropbox link) shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in bids rejection. The File link for submission of bids is included in the RFQ document.

Bids shall be submitted ONLY to the file request link provided in RFQ documents no later than 14 February 2022 at 14:00 (Kosovo Time). Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

## Contact Information:

<b>The address(es) referred to above is (are):</b>	Str. “Migjeni” no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
<b>Attn:</b>	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. “Migjeni” no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
<b>Tel:</b>	00 383 38 752 110
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:procurement@millenniumkosovo.org">procurement@millenniumkosovo.org</a>
<b>Website:</b>	<a href="https://millenniumkosovo.org">https://millenniumkosovo.org</a>



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



25.01.2022

**Njoftim për Tatimpagues****ATK, nxjerr Vendimin Shpjegues Publik Nr. 01/2022 për procedurat e trashëgimisë ligjore të Biznesit Individual pas vdekjes së pronarit**

Administrata Tatimore e Kosovës, nxjerr Vendimin Shpjegues Publik Nr. 01/2022 për procedurat e trashëgimisë ligjore të Biznesit Individual pas vdekjes së pronarit.

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është që të sqaroj procedurat nga aspekti tatimor, lidhur me trashëgiminë e Biznesit Individual pas vdekjes së pronarit.

Ky Vendim Shpjegues Publik ju dedikohet të gjithë tatimpaguesve të cilët kanë statusin e personit fizik afarist (Biznes Individual), si dhe të gjithë zyrtarëve të Administratës Tatimore të Kosovës, të cilët angazhohen në shqyrtimin e kërkesave të tatimpaguesve, inspektime dhe kryerjen e kontrollave tatimore.

Vendimin Shpjegues Publik Nr.01/2022 – për procedurat e trashëgimisë ligjore të Biznesit Individual pas vdekjes së pronarit, mund ta gjeni në ueb faqen e ATK-së [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org) në linkun [Publikime – Shpjegime Publike](#).

**Administrata Tatimore e Kosovës**

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 datë 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 25.01.2021 bënë shpallje publike për dhënie të pronës së paluajtshme me qira.

**Shpallje Publike****T-22-01**

Qëllimi i ofertës:	Dhënie me qira e hapësirave
Kriteret e Dhënies:	Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Data e shpalljes:	25.01.2022
Sqarimi:	deri me 10.02.2022
Kërkesa për pjesëmarrje:	Data(t) për kërkesës deri: 11.02.2022 Behet në e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave:	Dorëzimi i ofertave bëhet në formë fizike (zarf të mbyllur)
Afati i fundit i dorëzimit:	14.02.2022 në 10:00
Vendi i dorëzimit:	Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë

**AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

<b>Emri zyrtarë:</b> Trepça sh.a.		
<b>Adresa postare:</b> Parku inustrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
<b>Kontakti:</b> Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: <a href="mailto:sales@trepcacorporation.com">sales@trepcacorporation.com</a>		Faksi: +383 (0) 28 539 202
<a href="http://www.trepcacorporation.com">www.trepcacorporation.com</a>		



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS  
OSNOVNI SUDU PRISHTINI - BASIC COURT OF PRISTINA  
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE  
ODELJENJE ZA PRIVREDNE SPOROVE  
DEPARTMENT FOR COMMERCIAL MATTERS



III.EF.nr.7/2021

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,** me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur lidhur me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit të propozuesit-debitorit "Inter-Eminex" sh.p.k., me seli në Prishtinë zona industrial me NRB 80015232, kundër kundërpropozuesit-kreditorit 1.NLB-Banka me seli në Prishtinë,2.BKT Bank me seli në Prishtinë ,3.Mehmet Limani nga Prishtina rr."Lidhja e Prizrenit" nr.185 si dhe 4.Izet Limani nga Prishtina rr."Lidhja e Prizrenit"nr.183, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë 17.01.2022, merr këtë:

**Njoftim:** Për shpalljen Publike të Hapjes së Procedurës së Falimentimit

Propozuesit-debitorit "Inter-Eminex" sh.p.k ,me seli në Prishtinë zona industrial me NRB 80015232, panë kësaj gjykate me datë 14.12.2021, ka paraqitur kërkesë për falimentim.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin III.EF.nr.7/21 të datës 14.12.2021 ka vendosur për fillimin e procedurës së falimentimit për: "Inter-Eminex" sh.p.k ,me seli në Prishtinë zona industrial me NRB 80015232, me pronar-drejtor menaxhues Shefqet Ademi, me vendbanim në Prishtinë.

Njoftohen të gjithë kreditorët e mundshëm që kërkesat e tyre ti parashtrojnë pranë Administratorit falimentues të caktuar nga gjykata, Z.Virtyt Ibrahimaga, Rr "Anton Çeta" 5A, Prishtinë, brenda afatit prej 60 ditësh nga data e publikimit të shpalljes. Kërkesat e parashtruara me vonesë nuk do të merren për bazë.

Kreditorët kërkesat e tyre mund ti parashtrojnë në: Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, Pallati i Drejtësisë, Objekti A, Hajvali-Prishtinë



## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Jaser Mackaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Valbon Sezallari shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren .

► Abaz Guhelli shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Faik Karakushi Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha".

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




## PASHTETË PULE

MEKA  
HALAL FOOD

gluten  
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues